



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E APELIT VLORE

NR. 2426/1555 RREGJISTRI  
DATE 24.07.2013

NR. 280 VENDIMI  
DATE 20.02.2014

V E N D I M

**“NË EMËR TË REPUBLIKËS”**

Gjykata e Apelit Vlore, e perbere prej:

KRYESUESE: Alma LICAJ  
ANËTARE: Gjinovefa GABA  
ANËTAR: Skender DAMINI

Asistuar nga sekretare gjyqesore [REDACTED], sot ne Vlore, me date 20.02.2014, mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore me dyer te hapura ceshtjen civile qe i perket:

**PADITESE:** 1. [REDACTED] me atesi [REDACTED] dhe amesi [REDACTED], e dtl. [REDACTED] lindur e banuese ne [REDACTED] Lagja [REDACTED], Rruga [REDACTED], Banese private Nr. [REDACTED] me gjendje civile e martuar me femije, me gjendje gjyqesore e padenuar, identikuar me karte identiteti Nr. [REDACTED] date [REDACTED] perfaquesuar vet me deklaram.

**Paditesa ( Nderhyresa dytesore ) :** 1. [REDACTED] me atesi atesi [REDACTED] dhe amesi [REDACTED] dtl. [REDACTED] lindur ne [REDACTED] dhe banues ne [REDACTED] lagja [REDACTED], identikuar nga gjykata me leternjoftimin elektronik nr. Personal [REDACTED] date [REDACTED] leshuar nga autoriteti MB , ne mungese.  
2. [REDACTED] atesi [REDACTED] dhe amesi [REDACTED] dt. [REDACTED] lindur dhe banues ne [REDACTED] lagja [REDACTED], identikuar nga gjykata me pasaporte me nr. Personal [REDACTED], date [REDACTED] leshuar nga autoriteti MB , ne mungese.



RR612892203AA

3 [REDACTED] i mitur me zotesi te pjeshtme per te vepruar, me atesi [REDACTED] dhe amesi [REDACTED] me dtlindje [REDACTED], lindur dhe banues ne [REDACTED] lagjia [REDACTED], perfaqesuar ne kete gjykim nga kujdestaret e tij ligjor ne kuptim te nenit 8 te k.Civil dhe 232 te K.Familjes nga ati i tij [REDACTED] dhe nena e tij, paditesja [REDACTED] ne mungese.

**PALE E PADITUR:** 1. Drejtoria Rajonale Shendetesore Fier, perfaqesuar me autorizim Nr.66/2 Prot, date 15.02.2013 ne mungese.

**PALE E TRETE:** 1. Komisioneri per Mbrojtjen nga Diskriminimi , perfaqesuar me autorizim Nr.66/2 Prot. date 15.02.2013, ne mungese.

**OBJEKTI:** 1. Konstatimi i faktit te diskriminimit dhe viktinizimit ndaj paditeses , nga ana e pales se paditur Drejtoria Rajonale Shendetesore Fier.

2. Ndreqjen e shkeljeve ligjore dhe pasojave te ardhura duke me kthyer ne vendin e meparshem te punes ne pozicionin e pergjegjeses se sektorit te informacionit prane pales se paditur ose ne nje pozicion te barazvlefshem me te. Detyrimin e pales se paditur ta demshperbleje duke e kompensuar per demet pasurorete shkakfuara formen e fitimit te munguar per mosmarrjen e pages si pergjegjese e sektorit te informacionit prane pate se paditur, deri ne rikthimin e saj ne kete pune .Detyrimin e pales se paditur te me demshperbleje demin jopasuror te pesuar.

**BAZA LIGJORE:** Neni 18 dhe 49 te Kushtetutes te Rsepubikes se Shqiperise, neni 14 te Konventes Europeiane te te Drejtave te Njeriut, nenet 31, 32/a, 153. 154 te K.Pr.Civile, Nenet 3.7.12.13.343637.38 te ligjit Nr. 10221 date 04.02.2010 "Per Mbrojtjen nga Diskriminimi", si dhe nenet 608, 625te Kodit Civil.

*Gjykata e Rrethit Gjyqesor Fier, me vendimin Nr.1017 date 04.06.2013 ka vendosur:*

- Pranimin e padise.
- Konstatimi i faktit **te diskriminimit dhe viktinizimit** ndaj paditeses [REDACTED] ngal e pales se paditur Drejtoria Rajonale Shendetesore Fier.
- Ndreqjen e shkeljeve ligjore dhe pasojave te ardhura duke e kthyer paditesen [REDACTED] **ne vendin e meparshem te punes ne pozicionin e pergjegjeses se sektorit te informacionit pra pales se paditur** Drejtoria

Rajonale Shendetesore Fier , ose ne nje pozicion te barazvlefshem me te.

- Pushimin e gjykimit persa i perket kerkimit te pikes 3 te objektit te padise .
- Detyrimin e pales se paditur Drejtoria Rajonale Shendetesore Fier te demshperbleje padites [REDACTED] dhe nderhyresat dytesor [REDACTED] per demin jopasuror te pesuar dhe te specifikuar ne ate biologjik moral dhe ekzistencial ne vleren 4.507.8 (kater milion e peseqin e shtatemije e teteqind e gjashtedhjete e tete ) leke .
- Shpenzimet gjyquesore dhe ato per avokat ne masen 120.000 leke i ngarkohen pales se paditur.

*Kunder vendimit lejohet ankim ne Gjykaten e Apelit Vlore, brenda 15 diteve nga dita e neserme e shpalljes se ketij vendimi, pala e paditur Drejtoria Rajonale e Shendetesise, e cila ka kerkuar ndryshimin e vendimit dhe rrezimin e padise, duke parashtuar keto shkage:*

- Drejtoria Rajonale e Shendetesise Fier, kerkon rrezimin e Vendimi civilNr.62-2013-2010 (1017) si te pabazuar ne prova dhe ligj.
- Paditeses Znj. [REDACTED] ne Urdherin Nr.3, dt. 21.03.2011, nuk i jane nderprere marredheniet e punes prane institucionit, por eshte transferuar ne nje pozicion tjeter pune ne varesi te Drejtorese Rajonale te Shendetesise Fier. Znj. [REDACTED] eshte emeruar ne pozicionin Inspektore Statistike prane Drejtorese se Shendetit Publik Fier ne dt. 25.09.2006.
- [REDACTED] dhe emerimin e saj ne pozicionin Nd/Epidemiologe ne sherbimin e Kontrollit te Semundjeve Infektive prane Qendres Shendetore Portez (pozicion pune prane Drejtorese sone per mbledhjen e te dhenave ne Qendren Shendetesore Portez).
- Ky vendim eshte marre ne dt. 21.03.2011 dhe eshte urdheruar qe paditesja te paraqitet ne pozicionin e ri te punes ne dt. 20.04.2011, pasi ky vend pune lirohej ne po kete date me daljen ne pension te punonjeses qe mbante kete pozicion.
- Bazuar ne nenin 144 pika 3 te Kodit te Punes Znj. [REDACTED] i eshte komunikuar me shkrim ne shkresen 478 Prot., dt. 26.05.2011, vendim per largim nga puna. Gjithashtu theksojme faktin se paditesja i eshte drejtuar disa here gjykates duke ngritur padi ndaj DRSH Fier edhe ne rastin kur ne Urdherin Nr.3, dt. 21.03.2011, nuk i jane nderprere marredheniet e punes prane institucionit, por eshte transferuar ne nje pozicion tjeter pune ne varesi te Drejtorese Rajonale te Shendetesise Fier.

## GJYKATA E APELIT VLORE

Pasi degjoi relacionin e gjyqtares **Gjinovefa Gaba**, degjoi paditesen qe kerkoi lenien ne fuqi te vendimit, ne mungese te pales se paditur, pasi pa ceshtjen ne teresi,

## V E R E N

Vendimi Nr.. dt i Gjykates se Rrethit Gjyqesor Fier, eshte i drejte i bazuar ne prova e ligj, si i tille do te lihet ne fuqi.

Nga aktet dhe shqyrtimii ceshtjes ne shkalle te pare eshte provuar se, paditesja [REDACTED] prane Drejtorese Rajonale Shendetore Fier, ka punuar per nje periudhe prej 28 vitesh duke filluar prej vitit 1984. Ka rezultuar se para perfundmit te marredhenieve te punes, ka kryer me detyren e perjegjeses se sektorit informacionit shendetosor.

Paditesja ka parashtruar se me palen e paditur ka nisur konflikti per shkak se paditesja ka bere denoncim ne Departamentin e Kontrollit te Brendshem Administrativ dhe te Antikorrupsionit, Keshillit te Ministrave si dhe ne Ministrine e Shendetesise per faktin se ne kundershtim te hapur me ligjiii z. [REDACTED] ishte emeruar ne postin e zv/drejtorit ekonomik prane Drejtorese Rajonale te Shendetit Fier, duke qene pa diplome perkatese dhe pa asnjë procedure konkuruase.

Ne lidhje me kete situate ajo ka vene ne dijeni kryeministrine e vendit ,i cili ne perputhje me detyrimet tij kushtetuese ka urdheruar Departamentin e Kontrollit te Brendshem Administrativ dhe Antikorrupsionit per verifikimin e kesaj procedure emerimi.

Gjithashtu rezulton se ajo i eshte drejtuar Kontrolli i Larte te Shtetit ne lidhje me kete procedure. Kontrolli i Larte te Shtetit pas hetimit te kesaj ceshtjeje me date 24.02.2011, ka konstatuar se emerimi i z. [REDACTED] ishte bere ne shkelje te hapur te ligjit material dhe procedural dhe me shkresen nr.20/1 da 26.04.2011, dhe ka rekomanduar largimin nga detyra e zv/drejtorit ekonomik te z. [REDACTED]

Mbas marrjes dijeni per denoncimin qe paditesja kishte derguar prane K.L.SH. dhe insitucioneve te tjeri drejtori i D.R.SH. Fier, nisi kunder saj nje fushate te pashebullt diskriminuese duke pasur si qellim qe ta penalizonte rende per guximin qe ajo pati per denoncimin e aferes korruptive.

Per sa me siper, pala e paditur nepermjet urdherit nr.3 .dt.31.03.2012, te drejtorit e ka zbritur ate nga detyra e perjegjeses se sektorit te informacionit shendetosor ne detyren e ndihmes epidemiologes.

Ka rezultuar, se pas uljes ne detyre pala e paditur nuk kishte nderprere ndaj saj veprimet diskriminuese dhe perfundimisht me dt.26.05.2011 ne menyre te menjehershme ka zgjidhur marredhenien e saj te punes, nderkohe qe ishte me raport shendetosor si dhe ka nderhyre ne menyre sistematike per te bere dhe anullimin e ketyre raporteve.

Pala e paditur ne zbatim te ketij rekomandimi te K.L.SH., me urdherin nr.3,

date 21.03.2011, drejtori i D.R.SH. Fier, urdheroi shkarkimin e z. [REDACTED] nga detyra e tij e re qe mbante padrejtesisht **dhe si kunderveprim ndaj paditeses** ka berc emerimin e tij si Pergjegjes i Sektorit te Informacionit Shendetesor.

Njekohesisht ka urdheruar shkarkimin e paditeses nga kjo detyre duke e emeruar ne nje pozicion pune me te ulet dhe konkretisht **ne ate te Nd/Epidemiologe ne Qendren Shendetore Portez** ('infermiere).

Ky ndryshim i vendit te saj te punes ishte bere jo vetem pa pelqimin e saj , por ulja e saj ne detyre detyre i kishte sjelle ulje te ndjeshme ne page dhe konkretisht nje difference ne masen 20.000 leke te reja.

Per sa me siper, paditesia me pretendimin se si rezultat i qendrimit hakmarres te pales se paditur, ka pesuar shqetesime serioze te shendetit, ne zbatim te detyrimeve te saj ligjore si punemarrese, imbeshtetur ne nenin 608 e vijues te K.Civil, ka kerkuar detyrimin e te paditurit qe t'a demshperbleje per (te gjitha) demet pasurore dhe jo pasurore, dhe te tjera te nevojshme e te arsyeshme, te shkaktuara nga veprimet arbitrale te pa drejta padituritbazuar ne nenin 10/1 te kodit te Punes, drejtperdrejte pasi eshte trajtuar ne menyre me pak te favorshme nga grupi i kualifikimit.

Paditesja [REDACTED] pretendon se ndodhet ne Kushtet e qe paditesja i perket. Sipas nenii 3.2 te ligjit nr.10221 date 04.02.2010 "Per Mbrojtjen nga Diskriminimi" eshte percaktuar qarte se;

*"Diskriminimi i drejtperdrejte eshte ajo forme diskriminimi qe ndodh kur nje person apo grup personash trajtohen ne menyre me pak te favorshme sesa nje person tjeter, apo nje grup personash ne nje situate te njeje a te ngjashme, bazuar ne cilindo shkak te permendur ne nenin 1 te ketij ligji", Te gjithe keto veprime ndaj te paditures , paditesj [REDACTED], pretendon se klasifikohen edhe si "viktinizim" ne imbeshtetje te ligjit "For Mbrojtjen nga diskriminimi" , i cili ne nenin 3.8 percakton ; "Viktinizim " eshte trajtim i disfavorshcm apo pasoje negative, qe vjen si reagim ndaj nje ankimi a nje procedimi qe synon zbatimin e parimit te barazise".*

E gjithe kjo fushate diskriminuese erdhi sipas paditeses mbasi drejtori i D.R.SH. Fier, u vu ne dijeni te ankimit te te paditures ne K.L.SH., per emerimin e z. [REDACTED], te saj duke e detyruar te reagoje me.

Pala e paditur prapsoi ne seance gjyqesore se padia ishte e pambeshtetur ne ligj dhe prova shkresore dhe si e tille duhej te rrezohej .

Personi i trete pretenndoi ne gjykim se ekzistonte si fakt diskriminimi dhe viktinizimi qe i ishte bere paditeses gjate trajtimit te marredhenies se pune se saj, prandaj duhet ti pranohej padia ne te gjitha kerkimet e saj

2. Parashtime te paditeses , dhe provat shkresore sipas nenit 12 , dhe 31/1 te k.p.c te dhena ne sence gjyqesore.

Paditesja pohon per kete gjykate se ka qene e punes.\*ar prane DRSF Fier qe

prej vitit 1984 duke pretenduar se marredheniet e saj kishin vazhduar normalisht tek pala e paditur, pasi gjate kohezgjatjes se saj te punes ajo nuk ka patur asnjehere verejtje apo i . heqje vemendje nga eproret per shkak te mosbatimit te rregullave te punes prane institucionit ku ajo punonte .

Ne per shkak te denoncimit prej saj te emerimit te padrejte ne pozicionin e zevendesdrejtorit ekonomik te nje punonjesi qe nuk plotesonte kriteret e arsimit , pasi ishte me diplome te nivelit te parc dhe jo sipas kritereve te percaktuara nga Ministria e Financave per kete ceshje sipas permbjtjes se shkreses nr. 1086 ,dt.08.09.2010, paditesja ka denoncuar prane strukturave kompetente si Departamenti i Kontrollit te Brendeshem Adminsitrativ dhe Antikorrupsionit prane Keshillit te Minis trave dhe strukturave eprore te Ministrise se Shendetsise , si dhe prane institucionit Kontrollit i Larte i Shtetit. Nga kontrolli i ushtruar nga KLSH paditesja pretendon se ka rezultuar se praktika e ndjekur nga ana e pales se paditur si punedhenese ne emerimin e personit te denoncuar te ishte ne kundershtim me ligjin .Me konkretisht sipas ketij kontrolli rezultonte se emerimi i personit te denoncuar ishte bere ne kundershtim me kerkesate ligjit nr.9741,dt.21.05.2007 " Per Arsimin e Larte ne Republiken e Shqiperise " ,te amenduar dhe aktin nenligjor urdher, i konfonduar ne shkresen nr.1986 ,dt.08.09.2010 "Mbi zbatimin e vendimeve te reja te pagarc " , ku sipiij kesaj te fundit ne pozicionin e zevendesdrejtorit ekonomik nuk mund te emerohej nje nepunes me nje diplome te nje niveli me te ulet se DND apo DIND .

Pala e paditur ,nepermjet drejtorit te saj , ka nxjerre urdherin nr.3 ,dt.31.03.2012 ,me ane te te cilit urdherohej shkarikmi i paditeses nga detyra e perjegjeses se sektorit te informacionit shendetsor ne pozicionin e ndihmes epidemiologe prne Qendres Shendetsore Portez.

Me vendimin nr.279 ,dt.21.03.2011 te DRSH Fier personi i denoncuar kishte kaluar nga pozicioni i zevendesdrejtorit ekonomik ne pozicionin e punes qe mbante paditesja.

Paditesja pretendoi ne gjykim se me dt. 15.08.2008 eshte diplomuar ne Degen e Administrim Biznesit te Fakultetit Ekonomik te Universitetit "Aleksandri Xhuvani" , Elbasan , duke u paguar me pas si specialiste e me arsim te larte.

Ajo pretendon se gjate kohezgjatjes se saj te punes nuk ka patur asnjehere verejtje apo terheqje vemendje nga eproret e saj per shkak te mosbatimit le rregullave te punes .

Me daljen c urdherit nr.3 ,dt.31.03.2012 , ajo i ishte nenshtruar dukshem nje trajtimi te ndryshem dhe me pak te favorshem , pasi motivacioni i pennendur ne Is per gjoja shkelje te rregullave etike ne administraten publike dhe permerisim i ecurise se punes po e viktimidonte dhe diskriminonte per shkak se nuk rezultonin te provuara pretendimet e punedhenesit ne lidhje me shkarkimin e saj nga detyra. Ne te gjithe periudhen kohore te marredhenieve te punes me te paditurin, paditesja

pretendon se eshte shquar per korrektesi dhe profesionalizem ne ushtriin e detyres se saj, duke mos qene asnje here te vetme objekt i verejtjeve apo te terheqjes se vemendjes nga eproret e saj.

Si rezultat i ketij trajtimi inatcor dhe hakmarres i te paditurit ndaj paditeses, kjo e fundit pretendon pesuar dhe vazhdon te kete shqetesime serioze te shendetit te saj, fakt ky qe vertetohet edhe me ra mjekesor nr. 337 te rregjistrat, me diagnoze "Metroragji e zgjeruar dhe anemi sekondare", leshuar/iga mjeket specialiste gjinekologe te maternitetit Fier dhe nga data 25.05.2011 e ne vazhdim ajo kaifaqr probleme serioze te shendetit te saj, fakt qe vertetohet me vizita mjekesore dhe shtrim ne spitalinrf Fier nga *mjekja me kardiologe* [REDACTED]

Me prova shkresore (receta mjekesore) pala paditese i provoi gjykates sipas nenit 12 te k.p.c mjek e saj dhe terapine ne vazhdim.

Drejtori i D.R.SH. Fier, me shkresen e date 21.05.2011 i eshte drejtuar Maternitetit Rajonal te Fierit ka kerkuar verifikimin te raportit mjekesor qe i eshte dhene paditeses duke qene se ajo ishte shtruar Spitalin Rajonal Fier (Maternitet) per 8 dite, dhe me pas ishte trajtuar me regjim shtrati ne shtepi. Ky report mjekesor i vene ne diskutim pa te drejte dhe pa asnje shkak ligjor nga i padituri punedhen vinte dukshem ne diskutim seriozitetin dhe profesionalizmin e mjekeve te cilet kishin leshuar ato, duke sjelle me pas sipas paditeses nje diskriminim ky ne menyren me te papergjegjeshme e arrogante ndaj shendetit dhe personalitetit te paditeses [REDACTED]

Ne pergjigje te kesaj kerkese, mjeket e maternitetit, si rezultat i nje presioni nga ana e titullarit te te paditures , i jane perqjigjur me nje relacion duke anulluar ne menyre te pakuptimte kete report mjekesor i cili ne fakt ishte ezauruar edhe ne kohe, ne shkelje te plote me ligjet ne fuqi, rregullat e etikes profesionale dhe urdherit te mjekut, duke u Firmosur ky relacion per annullim te reportit vetem nga dy mjeke dhe jo nga tre sic e parashikon ligii.

Te dy mjeket ne fjale qe kishin firmosur kunder ketij reporti ishin pjesa e nje hetimi penal per shperdorim detyre ne Prokurorine e Rrethit Gjyqesor Fier .

Me date 26.05.2011, drejtori i D.R.SH. Fier kishte nxjerr edhe urdherin perfundimtar duke larguar perfundimisht nga puna paditesen , fakt qe i ka shkaktuar sipas epikrizes percjellese dt.29.05.2011 te Spitalit Fier, hypertension arterial ( HTA ).

Paditesja me date 13.03.2012 per veprimet e padrejta te kryera ndaj saj, i eshte drejtuar edhe Komisionerit per Mbrojtjen nga Diskriminimi (K.M.D.), i cili ka nisur nje hetim te plote te gjithanshe administrativ dhe ne vendimin e tij nr. 13, date 30.07.2012 ky komision, ka shpallur se z. [REDACTED] ishte diskriminuar dhe viktimalizuar per shkaqe abuzive.

Ky vendim bazohej ne nenin 1 te ligjit nr. 10221 date 04.02.2010 "Per Mbrojtjen nga Diskriminimi"ku percaktohet qarte se kush ishin shkaqet te cilat mund te

vendosin nje subjekt ne pozita diskriminuese ,d me konkretisht: Neni 1

"Ky ligj rregullon zbatimin dhe respeklimin e parimit te barazise ne lidhje me gjinine , racen, ngjyren, etnine, gjuhen, identitetin gjinor, orientimin sexual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike,arsimore ose shoqerore, shtatzanine, perkatesine prinderore, perjegjesine prinderore, moshen, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shendetore, predispozicionje gjenetike, aftesine e kufizuar, perkatesine ne nje grup te vecante ose me cdo shkak tie Sias nenin 3.1 po te ketij ligji fenomeni i diskriminimit perkufizohet;

"Diskriminimin eshte cdo dallim, perjashtim, kufizim apo preference, bazuar ne cilindo shkak te permendur ne neni 1 te ketij ligji, qe ka si qellim apo pasoje pengesen apo berjen e pamundur te ushtrimit ne te njejtene menyre me te tjeret, te te drejtave e lirive themelore te njohura me Kushtetulen Repub likes se Shqiperise, me aktet nderkombetare te ratifikuara nga R.Shqiperise, si dhe me ligj el ne fuqi"

Pra shkelja e parimit baze te barazise se shtetasve, ishte kushti i vetem dhe i mjaftueshem per te patur diskriminim pavaresisht formes ne te cilat mund te shfaqej shkaku abuziv.

Ne mbeshtetje te ketyre neneve te ketij ligji, paditesja pretendon se eshte diskriminuar per shkakun se ne fillim i eshte kufizuar profesioni, profesion perte cilin ajo eshte diplomuar dhe i eshte nenshruar te gjithe kualifikimeve perkatese, duke e ulur ne detyre .

Me tej ne nenin 12 te tij ligji parashikohej se edhe diskriminimi ishte edhe si pasoje e **perzgjedhjes dhe trajtimit te punemarresve** ku sipas ketij neni ishte percaktuar se ;

"Ndalohet diskriminimi i personit ne lidhje me te drejten e tij per punesim. Diskriminimi perfshin cdo

*dallim, kufizim ose perjashtim qe bazohet ne shkaqet e permendura ne nenin 1 te ligji dhe qe, nder te tjera, ka lidhje me ;*

*a-shpalljen e vendeve te lira te punes,*

*b-rekrutimin dhe perzgjedhjen e punemarresve,*

*c-trajtimin e punemarresve ne vendin e punes, dufa ,?rfshire trajtimin e tyre gjate vendosjes ose ndryshimit te kushteve te punes, shperblimin, perfisimet dhe mjesidin e punes, trajtimin lidhur me*

*trajtimet profesionale ose gjate procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontrates se punes.*

Pra eshte shume e qarte se ngjarja ne fjale eshte nje rast ipaster diskriminimi dhe viktinizimi.

Sipas Konventes Europeane per Mbrojtjen e te Drejtave te Njeriut, ne nenin 14 i saj ,eshte percaktuar

se;

"Gezimi i te drejtave dhe lirive te njeriut te parshikuara ne kete konvente, duhet te sigurohet pa asnje dallim te bazuar ne shkaqe te tilla si raca, ngjyra, feja, mendimet politike ose cdo mendim tjeter, origjina kombetare ose shoqerore, perkatesia ne nje minorilet kombetar, pasuria, lindja ose cdo status tjeter", ndersa po ne nenin 13 te kesaj konvente thuhet;

"Qdokush te cilit ijane shkelur te drejtat dhe lirite e percaktuara ne kete konvente, ka te drejten e nje zgjidhje efektive perpara nje organi kombetar pavaresisht se shkelja kryer nga persona qe veprojne ne perm bushje te funksioneve te tyre zyrtare".

Kushtetuta e Republikes se Shqiperise, ne nenin **18** te saj shprehej ne menyre te qarte se ; "Te gjithe jane te barabarte perpara ligjit, dhe askush nuk mund te diskriminohet padrejtesisht per shkaqe te tilla si gjinia, raca, etnia, bindjet politike, fetare a fdozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose perkatesia prinderore".

Nderkohe neni 44 i Kushtetutes percakton qarte se ;" Kushdo ka te drejte te rehabilitohet ose te zhdemtohet ne perputhje me ligjin, ne rast se eshte demtuar per shkak te nje akti, veprimi ose mosveprimi te paligjshem te organeve shteterore.

Pra , sipas pretendimeve te paditeses ngjarja ne fjale ishte nje rast i paster diskriminimi dhe viktinizimi dhe duhej konstatuar kjo gjendje fakti nga ana e gjykates sipas nenit 3,7,12,13,34,36,37,3S te ligjit nr.10221 date 04.02.2010 "Per Mbrojtjen nga Diskriminimi", si dhe te ndreqeshin pasojat duke u kthyer ne vendin e meparshem te punes si pergjegjese e sektorit te informacionit shendetosor apo ne ndonje pozicion pune te barazvlefshem me te .

Me vendimin nr.21,dt.08.11.2012 paditsja pretendon se i ishte vendosur nje gjobe ne masen 60.0 leke nga ana e Komisionerit te Mbrojtes nga Diskriminimi per moszbatham te vendimit nr. 13,dt.30. 2012 pales se paditur.

Gjithashtu ajo kerkonte mbi kete baze edhe detyrimin e pales se paditur ta demshperblente duke kompensuar per demet pasurore te shkaktuara ne formen e fitimit te munguar per mosmarjen e pa pergjegjese e sektorit te informacionit prane pales se paditur, deri ne rikthimin e saj ne kete pune.

## **2.1. Pretendimet paditeses ne lidhje me demin jo pasuror .**

Sipas kesaj dispozite ishte percaktuar se : "Personi qe ne menyre te paligjshme dhe me faj i shkakio tjetrit nje dem ne personin e tij ose pasurine e tij, detyrohet te shperbleje demin e shkaktuuar" Demi mund te kete karakter pasuror ose jo pasuror. Sipas nenit 625 i K.Civil percakton se; "Personi qe peson nje dem, te ndryshem nga ai pasuror, ka te drejte te kerkoje te shperblehet kitr ka pesuar nje demtim te shendetit ose eshte cenuar ne nderin e personalitetin e tij, Ky "demtim i shendetit"

perfshin jo vetem cenimin e shendetit ne kuptimin e ngushte te tij, por edhe cenimin e te drejtave per nje jete normale private e familjare e pa dhimbje shpirterore. Fakti i paligjshem, kundrejt saj si paditese kishte sjelle si pasoje pakesimin e marredhenieve familjare t paditeses, si dhe me te afermit e saj familjare, si rrjedhoje edhe cenimin e interesave te ligjshme jopasurore qe lidheshin me personalitetin e bashkejetuesve, si cilesia e jetes, paprekshmeria e familje solidariteti reciprok, dhimbja e vuajtja shpirterore e tyre, etj...

Demi pasuror kishte sjell si pasoje cenimin e pasurise se saj si e demtuar ne kuptimin e ngushte ekonomik, pra humbjen e pasurise (*deminutiopatrimonii*) ne menyre te paligjshme, prandaj edhe demshperblimi i demit pasuror qe i kerkohej gjykates kishte si qellim te rikthente pasurine e mepars te te demtuares ne gjendjen e meparshme, duke "mbushur" diferenca e krijuar ndermjet gjendjes ekonomike aktuale te saj me ate te cilin do te ndodhej nese nuk vertetohej fakti i paligjshem (*quantia res erit, tantam pecuniam condemnato*). Sipas nenit 640 i K.Civil ishte parashikuar ; .

*Demi ipasuror qe shperblehet perbehet nga humbja e pesuar dhe fllimi i munguar. Shperblehen gjithashtu shpenzimet te kryera ne menyre te arsyeshme per te shmangur ose pakesuar demin, ato qe kane kane te nevojshme per te percaktuar perqiegjesine dhe masen e demit, si dhe shpenzimet e arsyeshme te kryera per te siguruuar shperblimin ne rruge jashtegjyqesore.*

Ne Vendimin Unifikues nr. 12 date 14.09.2007, te Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte, ishte arritur ne perfundimin unifikues se: *Ne gjykimet me objekt detyrimet qe rrjedhin nga shkaktimi i dem nese paditesi kerkon demshperblimin "per te gjitha demet" apo "per te gjitha demet pasurore e jopasurore", kjo menyre kerkimi perben disponimin e tij per kerkimin e demshperblimit per cdo jigitr demit pasuror e jopasuror...*

Bazuar ne shkakun ligjor te padise ajo si pale paditese mendonte se ai ishte saktesisht i percaktuar ne nenet 608,625 e vijues te K.Civil dhe Vendimi Unifikues nr. 12.dt. 14.09.2007 te Kolegjeve te Bashku te Gjykates se Larte.

Ajo si pale paditese pretente se lidhur me themelin e kerkimit te objektit te padise, *konflikti gjyqeso buron nga marredhenia juridike e demshperblimit jashte kontraktor e cila gjen rregullim ne nenin 60 vijues te K. Civil si dhe ne rregullimet e posacme te legjislacionit mbi demet jashtekontraktore te shkaktuara..*

Ky nen jep edhe perkufizimin e shkaktimit te demit. Sipas kesaj dispozite : *"fersom qe ne menyre le paligjshme dhe me fqj i shkakton tjetrit nje dem ne personin ose pasurine e tij, detyrohet te shperbleje demin e shkaktuar."*

Neni 609 i K. Pr. Civile percakton se: "Demi duhet te jete rrjedhim i drejtperdrejt dhe i menjehershem i veprimit ose mosveprimit te personit

Nga interpretimi i dispozites se mesiperme rezidton se kater ishin e kushtet qe te lindte detyrimi nga

shkaktimi i demit jashte kontraktor.

**Konkretisht:**

*te ekzistoje demi;*

*ekzistenza e paligjshmerise se veprimit ose mosveprimit;*

*ekzistenza e fajit;*

*lidhja shkaksore midis veprimit ose mosverimil dhe pasojes (demit) te ardhur.*

Te kater keto kushte duhet te qendrojne bashkarisht (ne menyre akumulative) qe te ekzistoje detyrimi. **Veprimi ipaligishem** ne shkaktimin e demit cilesohet nje kategori objektive, shfaqja e kundraligjshme e vullnetitte subjektit te se drejtes qe sjell si pasoje shkeljen ose cenimin e te drejtave, lirive dhe interesave qe mbrohen nga rendi juridik dhe zakonet e mira. Kundraligjshmeria e sjelljes se subjektit shkaktar te demit cenon marredheniet juridike, qe gezojne mbrojtje nga Kushtetuta, aktet nderkombetare, ligjet dhe aktet nenligjore, te cilat njojin dhe garantojne te drejtat e personave fizik dhe juridik ne raport me njeri-jetrin dhe pushtetin publik.

**Fuji ishte** qendrimi subjektiv i personit shkaktar te demit ne raport me veprimin e kundraligjshem dhe pasojet qe vijne prej tij, qe nenkupton vullnetin e brendshem psikik per te kryer veprimin, per te siguruar ardhjen e pasojave ose lejimin e ardhjes se tyre.

**Lidhja shkakesore**, vleresohet si ekzistenza e lidhjes objektive, te drejtperdrejte dhe te pavarur nga vullneti i subjektit shkaktar te demit mes veprimit te kundraligjshem dhe pasojes se ardhur. Lidhja shkaksore verteton lidhjen mes tre elementeve objektive dhe subjektive te faktit te paligjshem, konkretisht *{sjelljes se paligjshme}, (fajit) dhe (pasojes se ardhur)*, pra demit te shkaktuar ne pasurine, shendetin ose personalitetin e subjektit te demtuar. Elementi i lidhjes shkakesore imbeshtetet ne parimin (*condicio sine qua non*) sipas te cilit nuk do te vertetohej ardhja e pasojes se demshme nese nuk do te kishte ndodhur shkaku, sjellja e paligjshme dhe faji per shkaktimin e demit. **Demi** i cili mund te kete karakter pasuror ose jo-pasuror.

Sipas nenit Neni 625 i Kodit Civil ishte parashikuar se: "Personi qepeson nje dem, le ndryshem nga ai pasuror, ka te dreje te kerkoje te shperblehet kur ka pesuar nje demtim te shendetit ose eshte cenuar ne nderin e personalitetin e tij.

Ne kete gjykim me objekt detyrim i i i dhurnga Jikaktimi i demit, ajo si paditesi kerkon demshperblimin "per te gjitha demet" apo "per te gjitha demet pasurore e jopasurore" dhe kjo menyre kerkimi ishte ne disponimin e saj per kerkimin e demshperblimit per cdo figure te demit pasuror e jopasuror. Padia permbante kerkime per demshperblimin e figurave konkrete te demit jashtekontraktor, gjykata sipas pretendiemve kishte detyrimin t'i permbahej ne gjykim dhe vendim ketyre kerkimeve specifike.

Ne rastin e demtimit te shendetit te saj nga fakti i paligjshem, sikurse ka ndodhur ne ceshtjen objekt i ketij gjykimi, ajo si padite se kishte pesuar dem **dhe kishte**

legjitimim aktiv per kerkimin e demshperblimit te demit pasuror e jopasuror te pesuar.

Paditesja pretendoi se kishte pesuar cenime te renda te shendetit e personalitetit te saj, ne marredheniet dhe interesat familjare, si ne aspektin pasuior dhe ate jo-pasuror. Ajo kerkonte rikthimin e gjendjes se saj te mepareshme, *sikur ky fakt i paligjsheni te mos kishte ndodhur*, duke u detyruar i padituri t'i demshperblente humbjet pasurore nga pakesimi i te dhurave ne familje, si dhe demet e tjera jopasurore shendetesore per vuajtjen shpirterore, cenimin e vlerave e te cilesise se jetes familjare , personate e private te tyre.

Neni 608 i K.Civil parashikohej edhe demshperblimin per demet jashtekontraktore te pesuara nga i demtuari "*ne personin ose ne pasurine e tij*".

Fakti i paligjshem, solli si pasoje pakesimin e marredhenieve prinderore familjare me paditesen, s rrjedhoje edhe cenimin e interesave te ligjshme jopasurore qe lidhen me personalitetin e tyre, si cilesia jetes, paprekshmeria e families, solidariteti reciprok, dhimbja e vuajtja shpirterore e tyre, etj...

**Demi pasuror si figure** e demit jashtekontraktor civil kishte sjell si pasoje edhe cenimin e pasuri se saj si paditese , e demtuar, ne kuptimin e ngushte ekonomik, pasi ishte shkaktuar humbja e pasuris (*deminutio patrimoni*) ne menyre te paligjshme. Prandaj edhe demshperblimi i demit pasuror kishte pe qellim te rikthente pasurine e saj si e demtuar ne gjendjen e meparshme, duke "mbushuf diferenca e krijuar ndermjet gjendjes ekonomike aktuale te saj me ate ne te cilind do te ndodhei nese nuk vertetohej fakti i paligjshem (quanti ea res erit, tantam pecuniam condemnato)".

Lidhur me demin pasuror, sipas nenit 640 i K.Civil ky dallohej nga humbja e pesuar nga pakesimi' pasurise, qe njihet si demi aktual apo demi emergjent (*dammum emergens*) dhe fitimin e munguar (*he cessans*). Ne parim, dallimi ndermjet demit emergjent (*quantum mini abest*) dhe fitimit te munguar (*quantum lucrari potui*), qendron ne aktualitetin ose jo te interesit pasuror te cenuar. Ne rastin e pare objekt i demit eshte pakesimi, humbja e nje interesi pasuror aktual, pra e nje pasurie qe i perket (*in re ipsa*) te demtuarit ne castin e shkaktimit te demit. Ne **rastin e fitimit te munguar** kishim te benim me pamundesine e perfitimit te nje interesi pasuror te ardhshem, pra te nje pasurie qe ende nuk i perket te demtuares ne castin e shkaktimit te demit.

Meqenese demshperblimi i kerkuar sipas nenit 643/a te K.Civil ishte dem pasuror ne formen e fitjf te munguar, paditesja si familjare vertetonte sipas nenit 12 te k.p.c me prova pozitive , mundesite konkrete, efektive, te kontributit ekonomik te saj ne te ardhmen qe s'mund te realizoheshin me si rrjedhoje e faktit te paligjshem (quantum debeat).

Ky pretendim i saj ishte ne funksion te percaktimit te llojit konkret te demit e te vleres se tij, sipa parimit te rregullshmerise dhe eficinces shkakesore juridike.

**Demi biologjik** i njojur ne teori si demtimi i shendetit perben ne thelb cenimin e shendetit dhe integritetit fizik e psikik te njeriut. Ky dem perbente objekt kerkimi te pavarur nga demi pasuror e lloje tjera te demit jopasuror dhe masa e demshperblimit duhet ti perafrohet shkalles konkrete te cenimit te perheshem ose te perkohshem te integritetit fizik ose psikik te te demtuarit. Ne kete kuptim, dispozitae nenit 625 te K.Civil bente dallimin ndermjet dy grupeve te te drejtave dhe lirive themelore te njeriut qe nuk kane natyre pasurore te mbrojtura prej saj ne rast cenimi: "*demtimi i shendetit*" (e drejta absolute shendetin, ne kuptimin biologjik) dhe *cenimi i "personalitetit"* (teresia e te drejtave absolute te personalitetit). Nisur nga natyra specifike e te drejtave qe mbrohen, ne paragrafin "a" te nenit 625, ligjvenesi kishte parashikuar;

"Personi qe pesonte nje dem, te ndryshem nga ai pasuror, kishte te drejte te demshperblehej kur: *pesuar nje demtim te shendetit ose eshte cenuar ne nderin e personalitetin e tij...*

Demtimi i shendetit te saj kishte ardhur si pasoje e cenimit te integritetit fizik dhe/ose psikik prej veprimve te padrejta te punedhenesit . Ajo duke patur barren e proves i pretendonte kesaj gjykate se demi kishte ndodhur, si dhe lidhjen shkakesore te tij me faktin e paligjshem.

Te drejtat e njeriut per jeten dhe shendetin jane te drejta objektive qe lindin dhe jane te padhunueshme e te pandashme me vete ekzistencen e tij. Prandaj si te tilla ato mbrohen e garantohen drejta themelore te njeriut nga Kushtetuta (Neni 3, 15/I dhe 21 i saj).

Mbrojtja e shendetit te njeriut meshirohet jo vetem ne detyrimin e shtetit per kujdesin shendetesor edhe ne te drejten per te realizuar kete mbrojtje ne gjykate, ndermjet te tjerave, duke detyruar cilindo cenonte integritetin e tij fizik e psikik te demshperbleje demin e shkaktuar.

Ndermjet fushave te se drejtes objektive qe sanksionojne mbrojtjen e shendetit te njeriut nga vepri a mosveprimet e paligjshme te te paditurit ne kete rast, ne Kd.Civil, posacerisht ne shkronjen "a" te ne 625, parashikohet se: "*Personi qe peson nje dem, te ndryshem nga ai pasuror, ka te drejte te kerkoje te demshperblehet kur ka pesuar nje demtim te shendetit...*".

**uemumi I snenueiu ^uenii OIUIO^JIK.;** perueii, ne uiciu, uciiiiinu c sc mura at **BU^UU^HI., MH.^6I »VIH** fizik dhe/ose psikik te njeriut. Ky dem jopasuror, i parashikuar nga shkronja "a" e nenit 625 te Kodit Civil, eshte objekt kerkimi dhe demshperblimi i pavarur nga deme te tjera pasurore e jopasurore te pesuara nga i demtuari per shkak te te njejt fakt te paligjshem. Meqenesejeta dhe shendetit i njeriut nuk ka cmim, ne respektim te parimit themeltar kushtetues te

barazise perpara ligjit dhe ndalimit te diskriminimit sipas nenit 18 te Kushtetutes, gjykata duhet te garantonte nje gjykim uniform dhe vleresim te njejte te perqindjes e te mases se demshperblimit te demit biologjik, per cdo forme e shkalle konkrete te cenimit te perhershesh a te perkohshem te integritetit fizik ose psikik te te demtuarit.

Demi biologjik, duke qene cenim ne integritetin fizik dhe/ose psikik te njeriut, ishte objektivisht i vertetueshem. Prandaj, ne zbatim te rregullave parimore te neneve 2, 6, 29 e vijues te K.Pr.Civile (*da mihifactum, dabo tibi ius*), ajo si e demtuari kerkon demshperblimin duke perdonur ne gjykim barren e proves kishte vertetuar se demi kishte ndodhur, si dhe lidhjen shkakesore te tij me faktin e paligjshem.

**Demi moral (pretium doloris ose pecunia doloris)** ishte shfaqje e brendshme, e perkohshme, e turbullimit te padrejte (*non iure perturbatid*) te gjendjes shpirterore te njeriut, dhimbje e vuajtje shpirterore apo gjendje ankthi e mundimi shpirteror qe rrjedh si pasoje e faktit te paligjshem. Cilido qe peson cenime ne sferen e shendetit dhe te personalitetit te tij nga veprimet a mosveprimet e paligjshme dhe me faj te nje te treti ka te drejten te kerkoste edhe demshperblimin e demit moral te pesuar. Kjo e drejte, ne cilesine e te demtuares, i perket individualisht asaj(*fc5proprietus*) edhe secilit prej familjareve te aferi te personit te cenuar ne shendetin e tij nga fakti i paligjshem, nese vertetohet lidhja e tyre e posacme familjare, ndjesore dhe e bashkejeteses. Demi moral i pesuar nga vete te afermit konsiderohet si pasoje, rrjedhim i menjehershesh dhe i drejtperdrejte i te njejtit fakt te paligjshem.

Barra e proves per vertetimin e demit moral ishte e saj si paditese por, nisur nga natyra subjektive e ketij demi dhe vecanerisht nga karakteri, shfaqja e brendshme e tij, vertetimi i cenimit te personalitetit te saj si e demtuar ne turbullime, dhimbje e vuajtje shpirterore, etj...., nuk mund te provohet ne menyre tjeter pervecse duke i vleresuar (ius receptum) si te mbeshtetura ligjerisht dhe duke i cmuar si te provuara (ipso iure) me vertetimin nga paditesja te vete faktit te paligjshem dhe lidhjes se ketij fakti me cenimin moral te pesuar, sipas parimit te rregullshmerise shkakesore. Duke qene prove ne formen e prezumimit te thjeshte, nese shkaktuesi i demit nuk arrin te vertetoje te kunderten, ajo merr te njeften vlere e fuqi te plete provuese sikurse prezumimi ligjor.(/w/y tantu neni 13 i K.Pr.Civile).

Ne kete rast, e demtuara pretendonte se provonte shkaktimin e demit moral me ane te prezumimit te thjeshte, pasi sa me e afert ishte lidhja gjinore familjare dhe e bashkejeteses, aq me e rende ishte edhe turbullimi e dhimbja shpirterore , te lenduarit ,te te afermit e saj, pra aq me e larte ishte shuma e demshperblimit moral qe duhet f i caktohet edhe nga gjykata.

Pervec prezumimit te thjeshte mbi ardhjen e pasojes morale nga asersia gjinore, per caktimin e mases se demshperblimit, paditesja kerkonte qe gjykata duhet te mbante parasysh se cdo individ kishte personalitetin e tij, unik dhe te ndryshem nga te

tjeren. Prandaj, edhe shkalla e vuajtes se pasojave morale dhe masa konkrete e demshperblimit ishte e ndryshme rast pas rasti. Per kete qellim sipas pretendimeve te paditeses duhet qe gjykata te shqyrtonte edhe rrrethana konkrete te ceshtjes per te cmuar ; se pari : shkallen efektive te dhimbjes e vuajtjes shpirterore te shkaktuar **dhe, ne lidhje me te**, natyren e faktit te paligjshem apo rrezikshmerine e tij nese perben veper penale, shkallen e fajesise dhe ne teresi menyren e sjelljes se shkaktuesit te demit ne raport me ngjarjen dhe personat e cenuar, natyren e se drejtes se cenuar dhe te pasojave te shkaktuara nga fakti i paligjshem, kushtet subjektive te te demtuara si mosha dhe shkalla individuale e ndjeshmerise ndaj cenimit te pesuar, si dhe rrrethanat qe lidheshin me kushtet sociale dhe ekonomike te te demtuarit, por pa cenuar ne kete rast parimin kushtetues te barazise para ligjit dhe te ndalimit te diskriminimit te njeriut per shkak te gjendjes sociale, ekonomike, etj, ne zbatim te nenit 18/2 te Kushtetutes.

Shuma e demshperblimit per demin moral, per shkak te natyres subjektive dhe te brendshme te tij, nuk mund te llogaritej mbi tabela dhe skema te paralogaritura vetem per kete qellim. Ai duhej llogaritur duke u mbeshtetur ne parimin e dhenies se drejtesise sipas bindjes se saj te brendshme te vete gjykates.

Te formuar nga shqyrtimi i te gjitha rrrethanave te ceshtjes ne teresine e tyre, duke u mbeshtetur edhe kritere eventuale normative te zbatueshme sipas natyres se te drejtes se cenuar ose, ne mungesc tetyB kritere dhe elemente vleresimi te konsoliduar nga praktika gjyqesore ne zgjidhjen e ceshtjeve analoge ne pervoja perkatese jashtegjyqesore, duke patur gjithnjë parasysh zhvillimin aktual ekonomik e socii vendit, perfshire vleren e parase ne ekonomine kombetare.

**Dem ekzistencial**, i shkaktuar nga fakti i paligjshem i te paditurit cenonte te drejtat e personalitetites si paditese, duke i demtar ne menyre te perherershme shprehjen dhe realizimin e saj si njeri, shfaqjene personalitetit te saj ne boten e jashtme, duke i tronditir objektivisht jeten e perditshme dhe veprimtar' ml zakonshme te saj, duke i shkaktuar perkeqesim te cilesise se jetes nga ndryshimi dhe prishja e ekuilibr sjelljes e zakoneve te jetes, te marredhenieve personale e familjare.

Demi ekzistencial, si shfaqje e jashtme e cenimit te interesave te ligjshme lidhur me cilesine e jetes, ndryshe nga ai moral, ishte objektivisht i vertetueshem nga provat e sjella nga ajo ne kete gjykim si nenit 12 te k.p.c dhe nuk mund te provohet vetem me ane te prezumimeve te thjeshta.

Gjykata duhet te pranonte vetem ato cenime, konkrete, te te drejtave te personalitetit te saj dhe qe pretendohen ngaajo si e demtuar si dem ekzistencial i pesuar..

Ne lidhje me caktimin e demshperblimit te demit ekzistencial, gjykata duhet te vendoste mbi rrrethana vertetonin ndryshim te dukshem e te rendesishem perkeqesues te jetes se perditshme dhe impaktin akt e te ardhshem te ketyre ndryshimeve ne interesat jopasurore dhe marredheniet e te demtuares me bote

jashtme .

Ne rastin e demtimit te shendetit te te afermit, per caktimin e mases se demshperblimit ekzistencial duh te mbante parasysh edhe afersine gjinore te saj si e demtuar, perberjen dhe gjendjen e bashkejeteses ne] familje, si dhe rrethanat e tjera qe provojnin perkeqesimin te gjendjes deri ne pamundesine e shprehjess aftesive se saj si e demtuar per te zhvilluar interesat dhe veprimtarine e perditshme. Demi moral ashtu edhe sikur demi ekzistencial kishin natyre subjektive, prandaj shuma e demshperblimit te saj duhej te caktohej ne menyre te pavarur nga demi moral, por duke zbatuar njejtat kritere dhe metoda te vlefshme per llogaritjen e demshperblimit te ketij te fundit.

Ne caktimin e mases se ketij demshperblimit paditesja pretendoi se duhej **marre ne konsiderate mosha, shkalla e larte te nevojes se perkujdesjes nga e demtuara ne fa mi I jen e saj, prishjen e ekuilibrave familjare dhe sociale per shkak te demit te shkaktuar, afersine gjinore e tyre me te demtuaren, tronditjen e marredhenieve familjare, veshtiresite e adoptimit ne ambientet shoqerore e sociale. Provat shkresore ne favor te pretendimve te saj :**

Me vendimin nr. 13,dt.30.07.2012 te Komisionerit te Mbrojtjes nga Diskriminimi paditesja i provoi gjykates se ishte konstatuar nga ana e komisionerit fakti i diskriminimit dhe i viktimizimit te paditeses nga drejtori i pales se paditur per shkak te denoncimeve te bera si dhe ishte bere rekomandimi per kthimin e paditeses ne vendin e meparshem te punes.

Me proven shkresore epikrize perçjellese ,dt.29.05.2011 te Spitalit Fier ,paditesja i provoi kesaj gjykate se ishte diagnostikuar me hipertension arterial ( HTA ) qe sipas saj ishte shkaktuar nga gjendja e depresionit si rrjedhoje e shkarkimit te saj nga detyra.

Me proven shkresore analiza te laboratorit '████████',dt.05.03.2013 ,pala paditese i provoi gjykates nepermjet analizave i provoi gjykates gjendjen e renduar shendetore ne vazhdim te saj. Me proven shkresore certifikate e perberjes familjare dt. 15.04.2013 te Zyres se Gjendjes Civile nr.████████ Bashkia Fier ,paditesja i provoi gjykates gjendjen e saj familjare dhe personat ne ngarkim.

### **1. Prapsime te te paditures dhe provat shkresore sipas nenit 12 , dhe 31/2 te k.p.c te dhena ne sene gjyqesore.**

Pala e paditur prapsoi ne seance gjyqesore se padia ishte e pambeshtetur ne ligj dhe prova shkresore d si e tille duhej te rrezohej.

Ne lidhje me detyren e paditeses punedhesi kishte patur ankesa pasi kjo si punemarrese kishte shkelur disa here rregullat e etikes ne administraten publike duke cenuar figuren e eporereve dhe ate te institucionit ku ajo punonte ,duke kaluar kompetencat ne lidhje me pozicionin e saj te punes.

Me urdherin nr.3 ,dt.31.03.2012 pala e paditur nepermjet drejtorit te saj e ka zbritur ate ne detyren e pergjegjeses se sektorit te informacionit shendetosor ne detyren e

ndihmes epidemiologes ,pasi ne kete vendim ajo kishte marre edhe pervojen e saj te punes si infermiere prej 28-vjetesh.

Me dt.20.04.2012 paditsja nuk ishte paraqitur ne pune ne pozicionin e ri t e detyres ,por ishte mjaftuar me nje lajmerimin telefonik se prej periudhes dt.26.04.2011 deri me dt. 12.05.2011 per shkaqe shendetvore nuk mund te paraqtej ne pune .

Sipas pales se paditur rezultonte qe punedhenesi gjate verifikimit te ketij reporti ka kerkuar verifikim te ketij modulari me shkresen nr.465 prot, dt.23.05.2011 dhe ka rezultuar me shkresen 741/1 prot, dt.23.05.2011 qe ky rapport te ishte deklaruar i pavlefshem dhe ishte annulluar.

Ne dt.23.05.2011 paditesja vazhdonte te mosparaqitej ne pune dhe per rrjedhoje punedhenesi i saj i kishte verejtje me paraljamerim per pushim nga puna.

Per shkak te mospermbushjes se detyrimeve te saj ligjore punedhenesi eshte detyruar te nxjerre me dt.26.05.2011 urdherin perfundimtar te largimit e saj nga detyra .

Gjate hetimi gjyqesor paditesaj ka paraqitur edhe reportin per paftesi te perkohshme ne pune prej dt.25.05.2011 deri me dt.01.06.2011 .raport me te cilin ajo si pale e paditur ishte njohur vetem ne seance gjyqesore dhe perderisa ky rapport nuk ishte paraqitur prane institucionit qe ajo perfaqesonte nuk mund te justifikohej mosprezenca e saj ne pune

E paditura prapson se nuk eshte i vertete pretendimi i paditeses marrdheniet e saj te punes ishin nderprere per shkak te hakmarrjes se titullarit te institucionit per shkak se kishte luftuar korruptionin , nderkohe qe vete pala paditese kishte qene jashte kritereve qe kerkonte ky vend pune per nje periudhe dy-vjecare.

Paditesja i ishte drejtuar disa here Gjykates per perfitimin e demshperblimeve qe rridhnin nga zgjidhja e menjehershme nga kontrata e punes ,keshtu qe nuk mund te perfiton demshperblim per here te trete. Ishin ne proces gjyqesor ne lidhje me titullin ekzekativ nr.21,dt.08.11.2012 te Komisionerit per Mbrojtjen nga Diskrimini, keshtu qe parashkrimi 30-ditor ne lidhje me ekzekutimin e vendimit nr. 13,dt. 30.07.2012 te mos merrej parasysh ,pasi ishte nderprere.

Duhej te thirrej ne kete gjykim edhe Avokatura e Shtetit si perfaquesuese e pales se paditur ,pasi kishim te benim me fonde publike.

## **2. Shpjegime te personit te trete Komisionerit per Mbrojtjen nga Diskriminimi, sipas nenit 180/3,192,195 tek.p.c.**

Ndodheshim para diskriminimit te drejteperdrejte dhe viktinizimit te paditeses sipas parashikimeve te ligjit nr. 10221 ,dt.04.02.2010 ,nenet 3,pika 1 , 2 ,8 .Ky diskriminim dhe dhe viktinizim i paditeses qendronte ne faktin se pala e paditur kishte ndermarre haptazi veprime ne dem te saj per shkak te ankimit qe kishte paraqitur paditesja ne KLSH ,ankim i cili kishte te benete me barazine e individeve ne lidhje me trajtimin e barabarte te individeve ne punesim.

Gjithashtu pala e paditur nc "transferimin" e marredhenies se punes se pales paditese kishte ulur ndjeshem pagen e paditeses , por gjithashtu ky vend pune nuk perputhej as me kerkesat dhe kriteret per detyren e infermieres.

Edhe ne emerimin e paditeses ne detyren e nd/ epidemiologes kishte ndjekur nje praktike ne kundershtim me urdherin nr.291 ,dt.20.07.2007 "Per kriteret e punesimit ne sherbimin shendetore publik" te Ministrit te Shendetie ,ku ne piken 1 te tij ishte percaktuar se kriteret e u punesimit si infermier do te ishin ne baze te nje konkurrimi te hapur dhe kritereve te unifikuara .Po ne shkresen e saj nr.887/1 ,dt. 17.03.2008 te Ministrise se Shendetise drejtuar Drejtorise se Shendetit Publik Fier, me lende : "Kujtese per kriteret e punesimit te infermiereve" , ishte parashikuar si kriter i rendesishem ne punesimit e personelit infermier pasja e diplomes se shkolles se larte ne infermieristike. Pala e paditur ne kundershtim me nenin 1 te ligjit nr.10221 , dt.04.02.2012 kishte diskriminuar palen paditese per shkak te te trajtimit te ne menyre te disfavorshme te gezimit te se drejtes se paditeses per pune ,e drejte kjo e grantuar nga Kushtetut ae Repubikes se Shqiperise dhe legjislacioni i punes ne fuqi.

Ne baze te ligjit nr.10221 , dt.04.02.2012 " Per mbrojtjen nga diskriminimi", nenet 33,pika 12 ,13 konstatuar me vendimin 13, dt.dt.30.07.2012 fakti i diskriminimit dhe viktizimit te te paditeses Ne baze te nenit 33/11 te ligjit nr.10221 , dt.04.02.2012 " Per mbrojtjen nga diskriminimi" duke qe paal e paditur nuk kishte zbatuar rekomandimet e saj per rikthim ne punen e meparshme ,ishte gjobit masen 60.000 leke, me vendimin e saj nr.21 ,dt.08.11.2012

Keto vendime ishin ne fuqi dhe nuk ishin ndryshuar apo shfuqizuar me vendim gjyqesor te formes s prere.

Ne baze te enenit 38 te ligjit nr. 10221,dt.04.02.2012 "Per mbrojtjen nga diskriminimi" demsperblim perfshinte ndreqjen e shkeljeve dhe pasojave te tyre nepermjet kthimit ne gjendjen e meparshme ,pra sipas saj ishte i bazuar kerkimi i paditeses ne kthimin e saj ne vendin e meparshem te punes si perje e sektorit te informacionit ose ne nje pozicion te barasvlefshem me te .

Gjithashtu ajo kerkonte qe pala paditese te perfitone edhe kompensimin e demeve pasurore te shkak ne formen e fitimit te munguar per mosmarrjen ,e pages si perjegjese e sektorit te informacionit deri rikthimin e saj ne kete pozicion pune.

Gjithashtu ajo kekronte qe te pranohej edhe kerkimi per demshperlim jopasuror sipas vleresimit bere ana e eksperteve te gjykates.

#### **4.) Therritja e ekspertit Trajtes te Demeve Shendetore z.██████████ dhe te ekspertit Vleresu Demi Shendetor z.██████████,sipas nenit 224/a te k.p.c .**

Me aktin e ekspertimit te dt.04.05.2013, pas ekzaminit mjekesor eksperti,██████████ kishte arritur ne konkluzionin shkencor se paditesja vuante nga hipertensioni

Arterial (Hta) dhe Depresioni .Nga ekzaminimi i karteles personale te te semures eksperti sqaronte gjykaten se paditesaj nuk kishte vuajt me pare nga hipertensioni apo ndonje semundje qe mund te shkaktonte hypertension. Kjo semundje is instaluar tek paditesja pas gjendjes stressante si pasoje e heqjes se saj nga puna dhe hipertensioni ishte kategorizuar ne grupin e pare ,ku origjina e shkaktimit te tij ishte stresi.

Paditesja vuante edhe nga gjendja depresive ankthioze ,me mendime autolize ,suicidale per te cilen i ishte dhene mijekim me antidepresive .Eksperti saronte gjykaten se nga kartela personale e paditeses n rezultonte qe ajo te ishtc kuruar me pare per gjendjen depresive per te cilen ajo paraqiste.

Si konkluzion sipas ekspertit paditesja ne baze te cenimit te aftesise fizike dhe psiqike te saj, kishte nj humbje te aftesise per pune ne masen 25 %.

Me aktin e ekspertimit nr. 14, dt.06.05.2013 **eksperti vleresues demi shendetor** [REDACTED] kishte arri duke u bazuar ne koeficientin e paftesise per pune ne masen 25% ,kishte arritur ne keto konkluzione:

**Demi pasuror** i nxjerre duke shumezuar koeficientin e shumes se kapitalizuar (sipas tabela "koficientet e llogaritjes se shumes se kapitalizuar") ne masen 14.225 , here koficientin e daljes ne pension ne masen 0.9 ,here koficientin e humbjes se aftesise per pune ne masen 25% ,here te ardhura mesatare te tret viteve te fundit nxirrej per vlere prej 425.053 leke ,nxirrje nje dem pasuror ne shumen 1.360.436 leke.

**Demi jopasuror** i ndare sipas figurave perkatese te ketij demi

a. **Demi shendetor apo biologjik** i perllogaritur nga shumatorja e te ardhrove per pune , koeficie e shumes s ekapitalizuar ,koeficientit te moshes se daljes per pension , koeficientit te humbjes se after per pune ,nxirrej nje dem biologjik ne masen 1.039.525 leke

b. **Demi moral i perhershem i perllogaritut** ne kufijte e raportit 'A deri ne Vz e shumes se caktuar demshperblim per demi biologjik te perhershem dhe konkretisht ne vlerat e tij minimale ne shumen 259.881 leke dhe ne vlerat maksimale ne shumen 519.762 leke.

c. **Demi ekzistencial** ne vlerat e tij minimale **prej 259.881 leke**,dhe ne ate maksimale **ne shumen 519.762 leke**.

d. **Demi moral i perhershem per te afermit e paditeses llogaritej** ne kufijte e raportit % deri ne shumes se caktuar si demshperblim per demi biologjik te perhershem dhe konkretisht ne kufijte e tij minimale prej 259.881 leke dhe maksimale prej 519.762 leke.

e. **Demi ekzistencial 1 perhershem per te alermit e paditeses llogaritej** ne kutijte e raportit 'A den ne Vi e shumes se caktuar si demshperblim per demi biologjik te perhershem **ne kufijte e tij minimale prej 259.881 leke** dhe maksimal **prej 519.762 leke**.

Vleratotale e demit paraqitej ne vlerat maksimale prej 4.507.868 leke dhe ne vleren minimale prej 3.468.343 leke.

Keto perllagaritje te tij ishin bere ne baze te ligjit nr.1 0076 ,dt. 12.02.2009 , rregullores per trajtimin e demeve nr.53 , dt.25.06.2009 "Mbi trajtimin e demeve" , udhezimit metedologjik nr.6,dt.30.08.2007 te { AMF,vendimit nr.12,dt. 14.09.2007 te Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte.

Pala paditese dhe personi trete ishin dakort me kete akt-ekspertimi dhe nuk paraqiten ndonje kundershtim .ndersa pala e paditur prasoi se nuk ishte dakort me kete akt-ekspertimi pasi nuk provohej siaps saj qe kjo gjendje shendetore kishte ardhur si rrjedhoje e pushimit te saj nga puna.

**5.) Gjykata pasi analizoi pohimet e paditeses, te paditures , provat shkresore, si dhe mbeshtetur ne bindjen e saj te brendshme sipas nenit 29/2 te k.p.c, konkludon se padia e paditeses duhet te pranohet pjeserisht .**

a. Paditesja , [REDACTED], legitimoitet ne ngritjen e padise sa me siper ne baze te nenit 32/a te Kodit te Procedures Civil ku thuhet se :

" padia ngrihet per rivendosjen e nje te drejte ose nje interes i ligjshem".

Paditesja ka te drejte e ngritjes se padise ne gjykate pa e lidhur me ndonje procedim te filluar me pare apo ezuarim te ndonje faze ankimi prane Komisionerit te Mbrojtjes nga Diskriminimi" ,pra aksesi i ngritjes se padise se mbrojtjes nga diskrimini eshte edhe drjetepersedrejti ne gjykate me kushte qe padia qe mbron kete institutit te se drejtes te ngrihet brenda afatit prekluziv jo me vone se 5 vjet nga dita qe ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo me vone se 3 vjet nga dita qe i demtuari merr dijeni per kete sjellje.

Me konkretisht sipas nenit 34 ,pika 1 dhe 2 te ligjit specifik nr.10221, dt.04.02.2012 "Per mbrojtjen nga diskriminimi", titulli "Subjektet qe kane te drejte te paraqesin padi per diskriminim" eshte parashikuar se :

Cdo person ose grup personash qe' pretendojne se ndaj tyre eshte ushtruar diskriminim per nje nga shkaqet e permendura ne nenin 1 te ketij ligji, mund te paraqesin kerkesepadi perpara gjykates kompetente sipas percaktiveve te Kodit te Procedures Civile per demshperblim sipas ligjit ose, sipas rastit, te kryejne kallezimin perpara organeve kompetente per ndjekje penale.

Paraqitja e ankimit perpara komisionarit nuk eshte kusht per te paraqitur nje kerkesepadi dhe nuk perben pengese per personin e demtuar t'i drejtohet gjykates ose organeve te ndjekjes penale. Siaps nenit 36 te ligjit specifik nr.10221, dt.04.02.2012 "Per mbrojtjen nga diskriminimi", titulli " Procedura para gjykates" ,eshte parashikuar se :

1. Padia i paraqitet gjykates kompetente nga nje prej subjekteve te parashikuara ne nenin 34 te ketij ligji jo me vone se 5 vjet nga dita qe ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo me vone se 3 vjet nga dita qe i demtuari merr dijeni per kete sjellje.

2. Demtuari nuk ka detyrim te njoftoje komisionarin para se te paraqese nje padi per diskriminim ne gjykate.

Gjykata e njofton komisionarin per paraqitjen e cdo padie per diskriminim. Gjykata mund t'i kerkoste komisionarin, ne cdo faze te procedimit, qe te paraqese nje mendim me shkrim, rezultatet e hetimit te tij, ne qofte se eshte bere hetimi, ose cdo informacion tjeter qe ka rendesi per ceshtjen.

Paditesi ka detyrim te sjelle prova ne mbeshtetje te padise, duke perdorur cdo lloj prove te ligjshme qe mund te provoje sjelljen diskriminuese.

Pasi paditesi paraqet prova, mbi te cilat bazon pretendimin e tij dhe ne baze te te cilave gjykata mund te prezumoje sjelljen diskriminuese, i padituri detyrohet te provoje se faktet nuk pe'rbejne diskriminim sipas ketij ligji.

Sipas nenit 37 te ligjit specifik nr.10221, dt.04.02.2012 "Per mbrojtjen nga diskriminimi", titulli "**Vendimi i gjykates**", eshte parashikuar se :

Vendimi i gjykates cakton demshperblim nese gjykata vendos qe ka shkelje te ketij ligji, duke perfs edhe nje afat kohor per kryerjen e zhdemtimit.

Vendimi i gjykates u komunikohet te gjitha pale've te interesuara, perfshire komisionarin.

Vendosja e masave, sipas ketij ligji, nuk perjashton vendosjen e masave sipas ligjeve te tjera.

Gjykata bazohet ne nenin 6 te K. Pr. Civile ku percaktohet qarte se: "*gjykata qe gjykon mosmarreveshjen duhet te shprehet mbi gjithcka qe kerkohet dhe vetem per ate qe kerkohet*".

Ajo ka parasysh nenin 16/1 K. Pr. Civile ku percaktohet se "*gjykata zgjidh mosmarreveshjen ne perpulhje me dipozitat ligjore dhe normal e tjera ne fuqi, qe jane te detyrueshme te zbatohen prej saj. ben nje cilesim te sakte te fakteve dhe veprimeve qe lidhen me mosmarreveshjen, pa u lidhur me pretendimin qe mund te propozojne palet. Megjithate gjykata nuk mund te ndryshoje bazen juridike te padise pa kerkesen e pales.*

Ajo ka parasysh nenin 28 te Kodit te Pr.Civile ku parashikohet se: "*Gjykata duhet te shprehet per gjitha kerkesat qeparashtron ne padi, pa i kaluar kufijte e saj, duke realizuar nje gjykim le drejte pavarur dhe te paanshem brenda nje afati te arsyeshem.*".

Ne kuptim te ketyre dispozitave gjykata ne ushtrimin e veprimtarise se saj, udhe'hiqet gjithnjë nga li nuk e paragjykon ceshtjen objekt gjykimi dhe u krijon paleve te gjitha hape'sirat ligjore per te realizua nje proces te te rregullt dhe te drejte gjyqesor.

.....b. Gjykata cmon se paditesja **eshte diskriminuar** nga vendimet e padrejeta te titullarit te pales se paditures ,si pasoje e qendrimit parimor te saj ne lidhje me emerimet ne pune te eprorit te saj ,i cili ishte duke shkelur trajtimin e barabarate te shtetasve ne lidhje me rekrutimin dhe perzgjedhjen e punemarres ne detyre si dhe

menyren e trajtimit te punemarresve te tij gjate vendosjes ose ndryshimit e te kushteve punes.

Diskriminimi i saj eshte ne forme te drejtperdrejte sipas cmimit te kesaj Gjykate, pasi paditesja eshtet trajtuar ne menyre me pak te favorshme nga grupi i kualifikimit qe ajo i perket. Gjykata cmon se paditesja **eshte viktimiduar** per shkak se punedhenesi i saj e ka trajtuar ne menyre te disfavorshme dhe me pasoja negative , te ardhura si reagim ndaj nje ankimi a nje procedimi qe synon I zbatim in e parimit te barazise.

Ne kuptim te nenit 3 pika 1 dhe 2 ,neit pika 8 te te ligjit nr.10221 , dt.04.02.2012 " Per mbrojtjen nga diskriminimi", konstatohen diskriminimi i drejteperdrejte ne pune i paditeses dhe viktimidimi i saj.

Rezultoi e provuar ne gjykim se fillimisht paditeses i eshte kufizuar profesioni, profesioni per te cilinajoi eshte diplomuar dhe i eshte nenshtruar te gjithe kualifikimeve perkatese, duke e ulur nga detyra e drejtoreshes sektori ne D.R.SH. ne ate te infermieres se thjeshte ne fshatin Portez, duke pasur difference page prej 20.000 lekesh.Kjo detyre e caktuar nga drejtori i D.R.SH.Fier jo vetem qe nuk pershtatet ,por as nuk justifikohet me diplomen qe disponon ajo .

Sipas neni 3.2 te ligjit nr.10221 date 04.02.2010 "Per Mbrotjen nga Diskriminimi" eshte percaktuar qarti

Se:

*"Diskriminimi i drejtperdrejte eshte ajo forme diskriminimi qe ndodh kur nje person apo grup personash trajtohen ne menyre me pak te favorshme sesa nje person tjeter, apo nje grup personash ne nje situate I njeje a te ngashme, bazuar ne cilind shkak te permendur ne nenin I te ketij ligji", Sipas nenit 3.8 te po ketij ligji eshte percaktuar se ;*

*"Viktimidizim" eshte trajtim i disfavors hem apo pasoje negative, qe vjen si reagim ndaj nje ankimi a nje procedimi qe synon zbatimin e parimit te barazise ".*

Kjo situate ka ardhur mbasi drejtori i D.R.SH. Fier, u vu ne dijeni te ankimit te te paditures ne K.L.SH., per emerimin e z. [REDACTED] ankim qe synonte barazine ndermjet individeve ne punesim. Ne nenin 12 te ketij ligji eshte parashikuar edhe diskriminimi si pasoje e **perzgjedhjes dhe trajtimit te punemarresve** ku ishte percaktuar se ;

*"Ndalohet diskriminimi i personit ne lidhje me te drejten e tij per punesim. Diskriminimi perjshin cdo dallim, kufizim ose perjashtim qe bazohet ne shkaqet e permendura ne nenin I te ligji dhe qe, nder te tjera, ka lidhje me :*

*a-shpalljen e vendeve te lira te punes,*

*b-rekrutimin dhe perzgjedhjen e punemarresve,*

*c-trajtimin e punemarresve ne vendin ^ punes, dukt perfshire trajtimin e tyre gjate vendosjes ose ndryshimit te kushteve te punes, shperblimin, perfitimet dhe mjesidin*

*e punes, trajtimin lidhur me trajtimet profesionale ose gjate procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontrates se punes.*

Si konkluzion per kete Gjykate se ngjarja ne fjale eshte nje rast ipaster diskriminimi dhe viktinizimi. Sipas Konventes Europiane per Mbrojtjen e te Drejtave te Njeriut, ne nenin 14 i saj ,eshte percaktohet se;

*"Gezimi i te drejtave dhe lirive te njeriut te parshikuara ne kete konvente, duhet te sigurohet pa asnje dallim te bazuar ne shkaqe te tilla si raca, ngjyra, feja, mendimet politike ose cdo mendim tjeter, origjina kombetare ose shoqerore, perkatesia ne nje minoritet kombetar, pasuria, lindja ose cdo status tjeter", ndersa ne nenin 13 te po kesaj konvente thuhet;*

*"Cdokush te cilit ijane shkelur te drejtat dhe lirile e percaktuara ne kete konvente, ka te drejten e nje zgjidhje efektive perpara nje organi kombetar navaresishti se shkelja kryer nga persona qe veprojne ne perm bushje te funksioneve te tyre zyrtare "*

Kushtetuta e Republikes se Shqiperise, ne nenin 18 te saj shprehet ne menyre te qarte se ; *"Te gjithe jane te barabarte perpara ligit, dhe askush nuk mund te diskriminohet padrejtesisht per shkaqe te tilla si gjinia, raca, etnia, bindjet politike, fetare a filozojike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose perkatesia prinderore "*.

*Nderkohe nenii 44 i Kushtetutes percakton qarte se ;" Kushdo ka te drejte te rehabilitohet ose te zhdemtohet ne perputhje me ligj in, ne rast se eshte demtuar per shkak te nje akti, veprimi ose mosveprimi te paligjshem te organeve shteterore.* Pra, gjykat gjen te bazuar pretendimet e paditeses qe ngjarja ne fjale ishte nje rast ipaster diskriminimi dhe viktinizimi dhe kjo gjendje fakti konstatohet nga ana e gjykates sipas nenit 3,7,12,13,34,36,37,38 te lisit nr. 10221 date 04.02.2010 "Per Mbrojtjen nga Diskriminimi".

b. Gjykata cmon se duhet te ndreqen edhe pasojat duke u kthyer paditesen ne vendin e meparshem te punes si pergjegjese e sektorit te informacionit shendetosor apo ne ndonje pozicion pune te barazvlefshem me te ,sipas ligit nr.10221 date 04.02 2010 "Per Mbrojtjen nga Diskriminimi" ,neni 38 .

Sipas nenit 38 te ligji te mesiperm titulli "Demshperblimi " eshte percaktuar se"; Demshperblimi perfshin, nder te tjera, ndreqjen e shkeljeve ligjore dhe te pasojave te tyre permes kthimit ne gjendjen e meparshme, kompensimin e duhur per demet pasurore si dhc jopasurore, ose permes masave te tjera te pershatshme.

c. Ekziston edhe deme jopasuror shkaktuar me faj civil shkaktuar paditeses nga e paditura ,sipas figurave konkrete te demit qe perfaqeson ky dem jashtekontraktor ne teresine e tij ne vleren e tij maksimale prej 4.507.868 leke.

Rezultoi e provuar ne gjykim me proven shkresoie akt ekspertimi te dt.04.05.2013 pas ekzaminit mjekesor te ekspertit eshte arritur ne konkluzionin shkencor se paditesja vunte nga hipertensioni Arterial (Hta) dhe Depresioni dhe kjo asaj i kishte shaktuar nje hyumbje te aftesise per pune ne masen 25%.

c.l **Ekziston dembiologjik** per shkak se demtimi i shendetit te paditeses u provua ne gjykim se kishte ardhur si pasoje e cenimit te integritetit fizik dhe/ose psikik prej veprimve te padrejta te punedhenesit

Gjykata cmon se te drejtat e njeriut per jeten dhe shendetin jane te drejta objektive qe lindin dhe a te padhunueshme e te pandashme me vete ekzistencen e tij dhe si te tilla ato mbrohen e garantohen si a drejta themelore te njeriut nga Kushtetuta (Neni 3, 15/1 dhe 21 i saj).

Mbrojtja e shendetit te njeriut meshirohet jo vetem ne detyrimin e shtetit per kujdesin shendetesorp edhe ne te drejten per te realizuar kete mbrojtje ne gjykate, ndermjet te tjerave, duke detyruar cilindo qt cenon integritetin e tij fizik e psikik te demshperbleje demin e shkaktuar.

Ndermjet fushave te se drejtes objektive qe sanksionojne mbrojtjen e shendetit te njeriut nga veprira a mosveprimet e paligjshme te te paditurit ne kete rast, ne K.Civil, posacerisht ne shkronjen "a" te nenit 625, parashikohet se: "*Personi qe peson nje dem, te ndryshem nga ai pasuror, ka te drejte te kerkoje tel demshperblehet kur ka pesuar nje demtim te shendetit ...*".

Demtimi i shendetit (demi biologjik) perben, ne thelb, cenimin e se mires se shendetit, te integritetit fizik dhe/ose psikik te njeriut.

Ky dem jopasuror, i parashikuar nga shkronja "a" e nenit 625 te Kodit Civil, eshte objekt kerkimi dhe demshperblimi i pavarur nga deme te tjera pasurore e jopasurore te pesuara nga i demtuari per shkak te te njejt fakt te paligjshem. Meqenesejeta dhe shndeti i njeriut nut ka cmim, ne respektim te parimit themeltar kushtetues te barazise perpara ligjit dhe ndalimit te diskriminimit sipas nenit 18 te Kushtetutes, gjykata duhet te garantoje nje gjykim uniform dhe vleresim njezte te perqindjes e te mases se demshperblimit te demit biologjik, per cdo forme e shkalle konkrete te cenimit te perhershems a te perkohshem te integritetit fizik ose psikik te te demtuarit.

Me kokretisht kjo figure e vecante e shkaktimit te demit (demit biologjik llogaritet sipas gjykate ne shumen 1.039.525 leke , i perllogaritur nga shumatorja e te ardhraive per pune , koeficienti e shumes se kapitalizuar ,koeficientit te moshes se daljes per pension , koeficientit te humbjes se aftesise per pune.

Paditesja i kalon vetite e njeriu mesatar dhe ka kualifikim arsimor te larte prandaj ky demshperblim eshte i drejte dhe kompeson demin e shkaktuar ne shendetin e saj.

c.2. **Ekziston demi moral i perhershem i perllogaritur** ne kufijte e raportit % deri ne *Vi* e shumes se caktuar si demshperblim per demi biologjik te

perhershem dhe konkretisht ne vlerat e tij minimale ne shumen 259.881 leke dhe ne vlerat maksimale ne shumen 519.762 leke.

Gjykata cmon se paditesja i kalon vetite e njeriu mesatar dhe ka kualifikim arsimor te larte prandaj demshperblim ne vlerat maksimale 519.762 leke eshte i drejtë dhe kompeson demin e shaktuar ne shendetin e saj.

**Demi moral {*preium doloris* ose *pecunia doloris*}** sipas emimit te kesaj GJYKATE eshte shfaqje e brendshme, e perkohshme, e turbullimit te padrejte (*non iure perturbatio*) te gjendjes shpirterore te njeriut, dhimbje e vuajtje shpirterore apo gjendje ankthi e mundimi shpirteror qe rrjedh si pasoje e faktit te paligjshem. Cilido qe peson cenime ne sferen e shendetit dhe te personalitetit te tij nga veprimet a mosveprimet e paligjshme dhe me faj te nje te treti ka te drejten te kerkoje edhe demshperblimin e demit moral te pesuar. Kjo e drejte, ne cilesine e te demtuarit, i perket individualisht (*ius proprius*), por edhe secilit prej familjareve te afert te personit qe ka humbur jeten apo te cenuar ne shendetin e tij nga fakti i paligjshem, nese vertetohet lidhja e tyre e posacme familjare, ndjesore dhe e bashkejeteses. Demi moral i pesuar nga vete te afermit konsiderohet si pasoje, rrjedhim i menjehershem dhe i drejtperdrejtë i te njejtit fakt te paligjshem.

c.3. Ekziston **demi ekzistencial** ne vlerat e tij maksimale **ne shumen 519.762 leke**. **Dem ekzistencial**, i shkaktuar nga fakti i paligjshem i te paditurit cenon te drejtat e personalitetit te saj si] paditese, duke i demtuar ne menyre te perhershme shprehjen dhe realizimin e saj si njeri, shfaqjen e personalitetit te saj ne boten e jashtme, duke i tronditur objektivisht jeten e perditshme dhe veprimtaritee zakonshme te saj, duke i shkaktuar perkeqesim te cilesise se jetes nga ndryshimi dhe prishja e ekuilibrit, sjelljes e zakoneve te jetes, te marredhenieve personale e familjare.

Demi ekzistencial, si shfaqje e jashtme e cenimit te interesave te ligjshme lidhur me cilesine e jetes, ndryshe nga ai moral, u vertetua ne nga provat e nc kete gjykim sipas nenit 12 te k.p.c dhe konkretisht sipsakt ekspertimi te dt.04.05.2013 lindin dhejai rantohen si te

Ne lidhje me caktimin e demshperblimit te demit ekzistencial, gjykata vendosi mbi rrethana qe vertetonin ndryshim te dukshem e te rendesishem perkeqesues te jetes se perditshme dhe impaktin aktual e te ardhshem te ketyre ndryshimeve ne interesat jopasurore dhe marredheniet e te demtuara me boten e jashtme .

c.4. **demi moral i perhershem per te afermit e paditeses llogaritej** ne kufijte e raportit % deri ne e shumes se caktuar si demshperblim per demi biologjik te perhershem dhe konkretisht ne kufijte e tij minimale prej 259.881 leke dhe maksimale prej 519.762 leke.

c.5. **Demi ekzistencial i perhershem per te afermit e paditeses llogaritej** ne kufijte e raportit  $V^*$  deri ne  $Vi$  e shumes se caktuar si demshperblim per demi

biologjik te perhershem **ne** kufijte e tij minimale prej 259.881 leke dhe maksimal prej 519.762 leke.

Ne caktimin e kesaj mases te demshperblimit ekzistencial Gjykata pati parasysh edhe afersine gjinore te saj si e demtuari, perberjen dhe gjendjen e bashkejeteses ne familje, dhe rr Ethanat e tjera qe provonin perkeqesimin te gjendjes deri ne pamundesine ne masen 25% te shprehjes se aftesive se saj si e demtuar per te zhvilluar interesat dhe veprimtarine e perditshme ne shoqeri deh familje .

d.Duhet **pushuar kerkimi i paditeses ne lidhje me fitmin e munguar** ,per kompensim per demet pasurore te shkaktuara ne formen e fitimit te munguar per mosmarrjen e pages si perjegjese e sektorit te informacionit prane pales se paditur deri ne rikthimin e saj tim ne pune. Rezultoi se pala paditese me vendimin gjyqesore nr.90,dt. 19.01.2012 ka perfituar demshperblim per zgjidhje te menjehershime te kontrates se punes duke ju dhene demshperblimi perkates ,c'ka perben per kete Gjykate edhe dhenien e fitmit te munguar dhe kompesim per gjendjen e krijuar per shkak te nderprerjes se kontrates se punes.

Kjo situate sipas kesaj gjykate perben "gje te gjykuar "sipas nenit 451/a te k.p.c dhe 640 te Kodit Civil. Gjykata **cmoi te panevojshme therritjen e Avokatures se Shtetit ,Zyra Vendore** ,pasi kishim te benim me demshperblime jopasurore qe rridhin nga zgjidhja e marrdhenies se punes ,ku avoktura e shteti nuk merr pjese.

Gjithashtu ne kete gjykim interesat e paditeses ishin te konfoduara me ata te personit te trete , Komisioneri per Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Ky i fundit sipas ligjit nr. 10221 date 04.02.2010 "Per Mbrojtjen nga Diskriminimi",neni 21, eshte person jurdik publik me buxhet te financuar nga buxheti i shtetit dhe donacione te ndryshme.

Gjate shpjegime te tij ,provave te paraqitura ,kerkimeve perfundimtare, gjykata krijo bindjen se ai ishte nje person i trete qe ishte bashkuar ne kete gjykim per te ndihmuar palen paditese. Sipas ligjit 10118 ,dt.03.11.2008 Neni 5,pika2, germa a si dhe ne akti nenligjor **Vendim Nr.392, date 8.4.2009 ,neni 4,titulli "Refuzimi i dhenies se asistences juridike"**, eshte parashikaur se

### **1. Avokatura e Shtetit nuk jep asistence juridike ne rastet e meposhtme:**

a) ne ceshtjet gjyqesore ndermjet organeve te administrates publike;

Ne rastin konkret kemi te bejme per nga organizimi juridik me dy organe te administrates publike , Komisioneri per Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Drejtore Rrjonale te Shendetit Fier, te cilat kane objekt te shqyrtimit gjyqesor veprimtarine e punedhenesisit ne lidhje me diskriminimin apo jo te paditeses ne pune dhe pasojat e ardhura nga keto veprime te tij .

Vete ligji specifik dhe akti nenligjor e ka te ndaluar prezencen e Avokatures se

Shtetit para njc rasti te til le , keshtu qe gjykata e pa te panevojshme therrijen e saj si subject procedural ne kete gjykim.

### **P E R K E T O A R S Y E**

Gjyakata bazuar ne nenin 18 dhe 49 te Kushtetutes te Rsepublikes se Shqiperise, neni 14 i Konventes Europiane te Drejtave te Njeriut, nenet 31, 32/a, 153, 154 te K.Pr.Civile, Nenet 3,7,12,13,34,36,37,38 te ligjit Nr. 10221 date 04.02.2010 "*Per Mbrojtjen nga Diskriminimi*",

### **V E N D O S I**

Lenien ne fuqi te vendimit nr.1017 date 04.06.2013 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Fier.

Vlore, me date 20.02.2014.

**ANETARE  
GJINOVEFA GABA**

**ANETAR  
SKENDER DAMINI**

**KRYESUESE  
ALMA LICAJ**



